

Velimir Dellovski

PLANI MËSIMOR (KURRIKULA)

PËR TRAJNIMET MBI
ZBATIMIN E AKTGJYKIMEVE
TË GJYKATËS EVROPIANE
TË TË DREJTAVE
TË NJERIUT

Velimir Dellovski

PLANI MËSIMOR (KURRIKULA)

PËR TRAJNIMET MBI ZBATIMIN E
AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE
TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Dedikuar për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm
në Akademinë për gjykatës dhe Prokurorë Publikë
“Pavell Shatev”

Botues:

Misioni i OSBE-së ne Shkup

Autor:

Vellimir Dellovski

Redaktorë:Darko Pavlovski
Artan Murati**Përktheu:**

Valon Abdiu

Lekturoi:

Lulzim Ademi

Dizajni grafik:

Polyesterdej, Shkup

Publisher:

OSCE Mission to Skopje

Author:

Velimir Delovski

Editors:Darko Pavlovski
Artan Murati**Translated by:**

Valon Abdiu

Proofread by:

Lulzim Ademi

Graphic design:

Polyesterday, Skopje

● Përmbajtja

Për nevojat e kësaj kurrikule	6
Për grupin e synuar	8
Për qëllimet dhe metodologjinë e trajnimeve	8
Rreth strukturës së moduleve	10
MODULI FILLESTAR (1)	15
MODULI I AVANCUAR (2)	22

ISBN 978-92-9271-054-5

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup. Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

Lidhur me përdorimin e emrit të vjetër të vendit në këtë botim:

Shteti zyrtarisht ndryshoi emrin kushtetues në vitin 2019 në përputhshmëri me Marrëveshjen e Prespës. Shumica e akteve ligjore të krijuara para ndryshimit të emrit akoma janë në fuqi dhe përmbajnë emrin e mëparshëm të shtetit në titujt e tyre zyrtare. Përdorimi i emrit të mëparshëm të shtetit në këtë dokument bëhet vetëm për shkak të saktësisë ligjore.

● Për nevojat e kësaj kurrikule

Në momentin e publikimit të kësaj kurrikule, një numër i madh i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) të sjella në lëndët maqedonase me të cilat është konstatuar shkelje e lirive dhe të drejtave të mbrojtura nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejshëm: "Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut" - KEDNJ) janë ende në pritje për t'u ekzekutuar dhe për t'u mbyllur nga Komiteti i Ministrave (në tekstin e mëtejshëm: KM) në kuadër të Këshillit të Evropës.

Ekzekutimi i aktgjykimeve të GJEDNJ-së është një proces i rëndësishëm dhe kompleks që përfshin faktorë të shumtë të përfshirë në vetë ekzekutimin ose në mbikëqyrjen e ekzekutimit, gjë që e ndërlikon dhe e ngadalëson zbatimin e çdo mase dhe aktiviteti që duhet të çojë në ekzekutimin efektiv të aktgjykimeve. Megjithatë, në praktikë vërehet se në publikun profesionist shpesh mungojnë njohuritë më të plota, e nganjëherë edhe ato elementare, si të kornizës së brendshme ligjore dhe institucionale për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së, ashtu edhe të mekanizmave të Këshillit të Evropës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve.

Prandaj, u imponua nevoja për hartimin dhe realizimin e trajnimeve dhe këshillimeve që për nga tema do t'i dedikohen këtij problemi specifik dhe që do të dedikohen si për gjyqtarët, prokurorët aktualë dhe kuadrin profesional të punësuar në gjykata dhe prokurori, ashtu edhe për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm, ndjekësit e Akademisë për gjykatës dhe Prokurorë Publikë "Pavel Shatev" (në tekstin e mëtejshëm: "Akademia për gjykatës dhe Prokurorë Publikë", "Akademia", "AGJPP").

Nëpërmjet vënies në funksion praktik të planit dhe programit mësimor të propozuar (Kurrikulës), pritet që të arrihet qëllimi parësor i ngritjes së vetëdijes së pjesëmarrësve në trajnime (kryesisht gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe bashkëpunëtorëve të tyre profesionalë dhe këshilltarëve të tyre) për rëndësinë e të kuptuarit të drejtë dhe ekzekutimit adekuat të aktgjykimeve të GJEDNJ-së të sjella në lëndët maqedonase me qëllim të zbatimit adekuat të së drejtës që buron nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe për të mundësuar mbrojtjen efektive të lirive dhe të drejtave të qytetarëve

në nivel nacional.¹ Në përgjithësi, kjo duhet të kontribuojë në ngritjen e ndjeshme të vetëdijes për rëndësinë e këtij problemi për reformën ligjore dhe jetësimin efektiv të parimit të sundimit të ligjit.

Në fakt, kjo kurrikulë bazohet në tre botime tematike të veçanta, por të ndërlidhura mes tyre, të cilat u përgatitën më parë me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, të cilat fokusohen pikërisht në ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së. Prandaj, kurrikula dhe publikimet plotësohen në mënyrë të ndërsjellë mes vete dhe të gjitha së bashku janë në funksion të avancimit të procesit arsimor që zhvillohet në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

Prandaj, gjatë përgatitjes së secilit prej trajnimeve, trajnerët e ardhshëm do të jenë në gjendje t'i marrin parasysh edhe tekstet e publikimeve të përmendura tashmë, që e përbëjnë trilogjinë e përgatitur me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, edhe atë:

- botimi "Ekzekutimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe konteksti institucional kombëtar";
- botimi "Mesazhet nga Strasburgu për Shkupin - udhërrëfyes për masat e përgjithshme për ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lëndët nga Maqedonia e Veriut", si dhe
- botimi "Masat individuale për ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si individualizim i ekzekutimit me theks të veçantë në përsëritjen e procedurave".

Në fakt, këto botime përmenden edhe në modulet përkatëse, gjegjësisht në orët e mësimi të paraqitura më poshtë, kështu që ato mund të shërbejnë si një mjet ndihmës mësimor i dobishëm si për trajnerët ashtu edhe për ndjekësit e trajnimit fillestar, gjegjësisht për pjesëmarrësit e trajnimit në vazhdimësi të Akademisë.

1 Në fakt, sipas pikëpamjeve të shprehura nga ndjekësit e trajnimit të vazhdueshëm në AGJPP, të prezantuara në Analizën funksionale të përgatitur nga Misioni i OSBE-së dhe nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, ata shfaqën një interes të veçantë për jurisprudencën e GJEDNJ-së e cila, sipas tyre, gjen zbatim në punën e tyre të rregullt, si dhe e theksuan nevojën për trajnime të reja për KEDNJ-në dhe praktikën e GJEDNJ-së me qëllim të ngritjes së mëtejshme të vetëdijes dhe cilësisë së punës së prokurorëve publikë dhe gjyqtarëve Shiko në Akademi për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë – analiza për pozicionimin e tanishëm të institucjonit si dhe roli i saj në trajnimin e kuadrit gjyqësor, Shkup OSBE-e 2020, mund të meret në: <https://www.osce.org/mk/mission-to-skopje/455473>, fq. 16, 54 dhe 61.

● Për grupin e synuar

Trajnimet për ekzekutimin e aktgjyqimeve të GJEDNJ-së e me këtë edhe kjo Kurrikulë, do të jenë të dedikuara për një spektër të gjerë përdoruesish nga gjyqësori, duke i përfshirë para së gjithash:

- gjyqtarët nga të gjitha gjykatat themelore dhe gjykatat e apelit,
- bashkëpunëtorët dhe këshilltarët gjyqësorë profesionalë nga të gjitha gjykatat themelore dhe gjykatat e apelit,
- prokurorët publikë nga të gjitha prokuroritë publike themelore dhe ato të larta, si dhe këshilltarët dhe bashkëpunëtorët e prokurorëve publik nga të gjitha prokuroritë publike themelore dhe ato të larta,
- ndjekësit e trajnimit fillestar dhe trajnimit në vazhdimësi në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

Në të njëjtën kohë, trajnime të veçanta që do të hartohen në bazë të kësaj kurrikule mund të organizohen edhe për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe për punonjësit e Gjykatës Kushtetuese, duke pasur parasysh rolin e saj si rojtar dhe mbrojtës i lirisë dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Për më tepër, këto trajnime do të mund të përshtaten dhe të zbatohen edhe për nevojat e klinikave juridike, si dhe punëtorive praktike dhe trajnimeve që zhvillohen në fakultetet juridike në vend.

● Për qëllimet dhe metodologjinë e trajnimeve

Përveç **qëllimeve teorike** të trajnimeve që kanë të bëjnë me përvetësimin teorik të lëndës, trajnimet kanë për detyrë edhe trajnimin praktik të gjyqtarëve dhe prokurorëve vendas për monitorimin e procesit të ekzekutimit të aktgjyqimeve të veçanta përmes qasjes në informata relevante për vetë lëndët apo grupet e lëndëve, duke i përfshirë edhe planet e veprimit dhe raportet e dorëzuara nga shteti, parashtrësat e vetë aplikantëve dhe/ose të organizatave joqeveritare, gjegjësisht të subjekteve të tjera të interesuara, si dhe rezolutat dhe vendimet e përkohshme dhe përfundimtare të marra nga KM-ja. Për këto arsye, Kurrikula parashikon që kohë e duhur t'i kushtohet edhe njohjes me bazën e të dhënave HUDOC-EXEC të Këshillit të Evropës.²

² Për një shikim të plotë në bazën e të dhënave mund të hyni përmes linkut të mëposhtëm: <https://hudoc.exec.coe.int/>.

Për më tepër, për të arritur **qëllimet praktike** të trajnimeve që synojnë zhvillimin e aftësive praktike për një kuptim të drejtë të lëndës dhe arsyetimin e duhur, gjegjësisht për zbatimin e njohurive teorike të fituara në kontekstin e lëndëve të veçanta ose grupeve të lëndëve, zbatimi i të cilave është në rrjedhë e sipër para KM-së, gjatë trajnimeve do të shqyrtohen edhe raste të veçanta, gjegjësisht do të bëhet një analizë e thellë e procesit të ekzekutimit të aktgjyqimeve të sjella nga GJEDNJ-ja në lëndët e Maqedonisë së Veriut.

Në këtë kuptim, nga aspekti metodologjik, trajnimet do të realizoheshin përmes shkëmbimit të njohurive teorike dhe përmes diskutimeve bashkëvepruese për praktikën e ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së, me fokus të veçantë në lëndët e Maqedonisë së Veriut. Me këtë rast, rekomandohet të bëhet kombinimi i metodave, teknikave dhe mjeteve edukative, të cilat do të përfshijnë ligjërata dhe prezantime, duke përfshirë edhe formën Power Point (PPT), si një teknikë vizuale e bartjes së njohurive dhe përvojave të ligjëruesve të Akademisë, paraqitjen e mendimeve të pjesëmarrësve të trajnimeve në kuadër të teknikës së quajtur "*brainstorming*" (ose e ashtuquajtur "stuhi idesh"), si dhe përfshirjen e tyre në diskutim rreth përvojave të tyre me ekzekutimin e aktgjyqimeve të GJEDNJ-së (nëse kanë pasur përvojë të tillë) dhe në punë praktike në grupe, ku do të kenë për detyrë ta analizojnë procesin e ekzekutimit të aktgjyqimeve konkrete të GJEDNJ-së të shqiptuara në lëndët e Maqedonisë së Veriut.

Me rastin e hartimit të temave, përkatësisht të përmbajtjeve mësimore që do të përpunohen dhe diskutohen në secilin prej moduleve, përkatësisht orëve të mësimi, përveç pjesës teorike përkatëse, vëmendje e veçantë i kushtohet edhe pjesës praktike, gjegjësisht analizës dhe diskutimit të lëndëve konkrete (aktgjyqimet e GJEDNJ-së në lëndët e Maqedonisë së Veriut që janë në fazën e ekzekutimit para KM-së).

Përndryshe, kjo strukturë e këtij programi trajnues (Kurrikule) i pasqyron edhe qëndrimet e shprehura nga të anketuarit në bazë të pyetësorit që u është shpërndarë gjatë realizimit të Analizës funksionale të Akademisë, që tashmë u përmend.³

Për t'i arritur qëllimet e trajnimeve dhe për t'u përmbajtur kornizës së përcaktuar metodologjike, sugjerohet që trajnimet të zhvillohen në grupe më të vogla që do të përfshinin nga 15 deri në 25 pjesëmarrës, për t'u mundësuar të gjithë pjesëmarrësve të marrin pjesë aktive në to. Në të njëjtën kohë, secili prej moduleve do të realizohet brenda një ose më shumë orëve mësimore, të cilat janë të përcaktuara në atë mënyrë që do të lejojnë kohë të mjaftueshme,

³ Në fakt, sipas rezultateve të kësaj ankete, ndjekësit e trajnimit fillestar theksuan se është e nevojshme që në trajnim të jetë më e përfaqësuar praktika edukative, e më pak teoria (fq. 35). Nga ana tjetër, të anketuarit nga radhët e përfituesve të trajnimit të vazhdueshëm në AGJPP, konsiderojnë se nevojiten edhe më shumë ushtrime praktike dhe trajnime (fq. 54).

si për prezantimin e përmbajtjeve të planifikuara tematike, ashtu edhe për diskutim të hapur dhe analizë të rasteve të përzgjedhura.

Rreth strukturës së moduleve

Materiali që planifikohet të shqyrtohet gjatë realizimit të mësimdhënies në Akademi, nga aspekti tematik është i ndarë në dy njësi kryesore tematike (dy module), edhe atë: moduli fillestar (1) dhe moduli i avancuar (2) i cili ka dy variante, si dy module të avancuara të specializuara (2.1. dhe 2.2.), që u referohen gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, si dhe këshilltarëve gjyqësorë që punojnë në lëndët civile dhe administrative (2.1.), gjegjësisht në lëndët penale dhe të kundërvajtjes (2.2.). Varianti i dytë i modulit të avancuar (2.2.) është i zbatueshëm si për prokurorët publikë ashtu edhe për bashkëpunëtorët profesionalë dhe këshilltarët e prokurorive publike. Përndryshe, secili prej këtyre moduleve përbëhet nga disa nën-module (të shënuara me numrin e modulit dhe A, B ose C), të cilat realizohen brenda një ose disa orëve mësimore.

Moduli fillestar (1) ofron mundësi për njohje me problemin dhe për të marrë njohuri bazë në lidhje me detyrimin e marrë ndërkombëtarisht të shteteve për të ekzekutuar aktgjykimet e GJEDNJ-së, llojin e masave (individuale dhe të përgjithshme) për ekzekutimin e aktgjykimëve të GJEDNJ-së, kornizën normative kombëtare dhe strukturën institucionale për ekzekutimin e aktgjykimëve të GJEDNJ-së, si dhe mënyrën e funksionimit të mekanizmit të mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjykimëve të GJEDNJ-së të krijuar nga Këshilli i Evropës dhe i mishëruar përmes KM-së së tij. Në të njëjtën kohë, gjatë ndjekjes së modulit fillestar, pjesëmarrësit e trajnimit do të fitojnë edhe aftësitë bazë për kërkimin ligjor dhe monitorimin e procesit të ekzekutimit të aktgjykimëve konkrete të GJEDNJ-së përmes bazës së të dhënave HUDOC-EXEC të Këshillit të Evropës.

Më konkretisht, ai mund të realizohet brenda 6 (gjashtë) orëve mësimore nga trajnimi fillestar, si pjesë integrale e Modulit 3, i cili i referohet të Drejtës ndërkombëtare me theks të KEDNJ-ja dhe praktika e GJEDNJ-së, gjegjësisht në kuadër të përmbajtjeve mësimore të pjesës III Mbrojtja ndërkombëtare-juridike e të drejtave të njeriut në sistemin e Këshillit të Evropës, në pikën 5. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), për të cilën janë parashikuar gjithsej 14 orë mësimore (4 orë pjesa teorike dhe 10 orë pjesa

praktike).⁴ Duke pasur parasysh se një nga çështjet që duhet trajtuar në pikën 5. është pikërisht ekzekutimi i aktgjykimëve të GJEDNJ-së, do të ishte e përshtatshme që 6 (gjashtë) nga 14 orët e parashikuara për këtë pikë të realizoheshin në përputhje me programin e kësaj Kurrikule.

Gjithashtu, për gjyqtarët, prokurorët dhe personelin tjetër gjyqësor, ky modul mund të realizohet si pjesë e edukimit të vazhdueshëm të Akademisë në kuadër të këshillimit njëditor që do të përfshijë 6 (gjashtë) orë mësimore në kohëzgjatje prej 45 minutash. Prandaj, do të ishte e dëshirueshme që moduli fillestar (1) të përfshihet në Katalogun për trajnimin e detyrueshëm të vazhdueshëm të AGJPP-ës.

Me këtë rast, moduli fillestar (1) do të mund të strukturohej si më poshtë:

MODULI 1. A	HYRJE NË EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
MODULI 1. B	SISTEMI PËR EKZEKUTIMIN DHE MBIKËQYRJEN MBI EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
MODULI 1. C	LLOJET E MASAVE PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Moduli i avancuar (2) synon të mundësojë thellimin e njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe kuadrit profesional, të punësuar në gjykatat dhe prokuroritë, të cilët tashmë kanë e kaluar modulën fillestar (1) për ekzekutimin e aktgjykimëve të GJEDNJ-së. Prandaj, ai u krijua kryesisht për t'u integruar në kuadër të Katalogut për trajnimin e detyrueshëm të vazhdueshëm të AGJPP-së.

Në fakt, siç u përmend më lart, ky modul ka dy variante, pra mund të zbatohet në formën e dy moduleve të specializuara, të cilat janë krijuar për të përmbushur nevojat e kategorive të ndryshme të gjyqtarëve, prokurorëve dhe punonjësve në sektorin e drejtësisë, varësisht nga fakti nëse pjesëmarrësit e përzgjedhur për trajnime kryesisht punojnë në çështje civile dhe administrative apo penale dhe të kundërvajtjes.

Përndryshe, planifikohet që programi mësimor (Kurrikula) për secilin nga variantet e modulit të avancuar (2) të realizohet brenda 6 (gjashtë) orëve mësimore në kohëzgjatje prej 45 minutash. Njëkohësisht, në kuadër të orëve mësimore, të cilat janë paraqitur më poshtë, vëmendje e veçantë do t'i

⁴ Programi i trajnimit fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë "Pavel Shatev", mësimi teorik 2022/2023, i miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2022, në dispozicion në: https://jpacademy.gov.mk/wp-content/uploads/2022/09/Programa_za_pocetna_obuka_teoretska_nastava_2022-2023.pdf, fq. 64.

kushtohet sfidave specifike që kanë të bëjnë me ekzekutimin e aktgjykimeve në lëndët civile dhe administrative, përkatësisht në lëndët penale dhe të kundërvajtjes, me theks të veçantë në lëndët maqedonase para GJEDNJ-së.

Moduli i avancuar për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së në lëndët civile dhe administrative (2.1.) është strukturuar si më poshtë:

MODULI 2.1. A	PËRSËRITJA E PROCEDURAVE PAS AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË LËNDËT CIVILE DHE ADMINISTRATIVE
MODULI 2.1. B	MASAT E PËRGJITHSHME PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË LËNDËT CIVILE DHE ADMINISTRATIVE
MODULI 2.1. C	ANALIZË E RASTIT

Moduli i avancuar për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së në lëndët penale dhe të kundërvajtjes (2.2.) është strukturuar si më poshtë:

MODULI 2.2. A	PËRSËRITJA E PROCEDURAVE PAS AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË LËNDËT PENALE DHE TË KUNDËRVAJTJES
MODULI 2.2. B	MASAT E PËRGJITHSHME PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË LËNDËT PENALE DHE TË KUNDËRVAJTJES
MODULI 2.2. C	ANALIZË E RASTIT

Përmbajtja e secilës prej orëve mësimore që e përbëjnë modulin fillestar (1), gjegjësisht modulin e avancuar (2), është shtjelluar në detaje dhe është paraqitur në vazhdim të këtij plani dhe programi mësimor (Kurrikule). Me këtë rast, janë paraqitur temat që duhet të trajtohen në çdo orë mësimore, nga secili modul i veçantë, lëndët që do të analizoheshin, si dhe literatura përkatëse, përkatësisht materialet e punës dhe dokumentet që lidhen me temat e dhëna.

Kështu, për çdo orë mësimore, varësisht nga temat që trajtohen në të, ofrohen si referencë një ose disa botime nga trilogjia e botuar nga Misioni i OSBE-së në Shkup, ku mund të gjenden informacione më të detajuara për temën përkatëse, të cilat janë të dobishme si për vetë ligjëruesin gjatë përgatitjes së trajnimit, ashtu edhe për pjesëmarrësit në trajnim. Atyre, këto botime mund t'u shërbejnë si lexim shtesë, të cilit mund t'i kthehen në çdo kohë pas përfundimit të trajnimit, kur gjatë kryerjes së detyrave të tyre të

përditshme të punës do të përballen me ndonjë çështje apo dilemë lidhur me temën e ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së.

Përveç kësaj, Kurrikula ofron gjithashtu udhëzime edhe lidhur me legjislacionin përkatës vendas dhe instrumentet përkatëse ligjore ndërkombëtare që përmbajnë standarde të caktuara që kanë të bëjnë me temën dhe çështjet që shqyrtohen brenda një ore të caktuar mësimore.

Në fund, kur është e nevojshme, në përfundim të prezantimit të çdo ore mësimore, gjegjësisht të disa orëve të njëpasnjëshme mësimore (në rastin kur një njësi e caktuar tematike, duke pasur parasysh vëllimin e saj, planifikohet të shtjellohet gjatë më shumë se një ore mësimore) jepet edhe një pasqyrë e disa lëndëve të rëndësishme për të cilat GJEDNJ-ja ka nxjerrë aktgjykim, ose, në raste më të rralla, vendim. Në fakt, bëhet fjalë për lëndë që janë veçuar si lëndë referente në praktikën e pasur të GJEDNJ-së, sepse me to vendosen standarde me rëndësi për temën që është pjesë e një moduli të caktuar dhe që përpunohet në kuadër të një orë të caktuar mësimore, gjegjësisht të disa orëve mësimore. Gjatë përzgjedhjes së lëndëve është marrë parasysh që ato të paraqesin precedentë në nivel të GJEDNJ-së ose të kenë rëndësi të veçantë në kontekstin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila rezulton nga aplikimet e parashtruara në lëndët maqedonase. Më rrallë janë theksuar edhe disa vendime nga praktika gjyqësore vendase.

Gjithashtu, në lidhje me çdo orë mësimore, gjegjësisht për të gjitha orët mësimore ku është e rëndësishme, referohen edhe parashtresat në KM (planet e veprimit dhe/ose raportet e veprimit të shtetit ose parashtresat nga aplikantët ose palët e tjera të interesuara) të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me procesin e ekzekutimit të një aktgjykimi të caktuar ose një grupi aktgjykimesh të GJEDNJ-së të sjella në lëndët maqedonase. Megjithatë, ato nuk përmenden individualisht, por jepet vetëm një shënim i përgjithshëm se ato janë shënuar në publikimin përkatës të GJEDNJ-së (kur bëhet fjalë për masat e përgjithshme për ekzekutimin e aktgjykimeve) dhe se janë në dispozicion përmes bazës së të dhënave HUDOC-EXEC të Këshillit të Evropës.

Në të njëjtën kohë, për disa orë mësimore, jepet edhe udhëzimi për përdorimin e disa ueb-faqeve si burim i të dhënave dhe informatave që kanë të bëjnë me temën e trajtuar në atë orë mësimore ose në disa orë të njëpasnjëshme mësimore.

Përndryshe, lista e ligjeve relevante dhe akteve juridike ndërkombëtare, si dhe e lëndëve referente të cilave u referohet kjo kurrikulë, nuk është përfundimtare, kështu që ajo mund të vazhdojë të plotësohet dhe të përditësohet, duke e ndjekur dinamikën e miratimit të vazhdueshëm të ligjeve të reja, gjegjësisht të ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore në nivel nacional ose të pasurimit të kornizës normative të Këshillit të Evropës, si dhe duke marrë parasysh miratimin e aktgjykimeve të reja, gjegjësisht vendimeve

të GJEDNJ-së, disa prej të cilave duket se janë veçanërisht të rëndësishme dhe për këtë arsye, ato duhet të shqyrtohen edhe në kuadër të trajnimeve të AGJPP-së.

Gjithsesi, përditësimi i vazhdueshëm i kësaj Kurrikule me materiale të reja, si literaturë e nevojshme për përgatitjen dhe realizimin e trajnimeve nga ligjëruesit, si dhe për konsultim nga ndjekësit e trajnimit fillestar dhe pjesëmarrësit e edukimit në vazhdimësi të Akademisë, mbetet një sfidë e madhe, me të cilën duhet të përballen ligjëruesit që janë angazhuar nga AGJPP-ja për të udhëhequr procesin arsimor në fushën e ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së.

● MODULI FILLESTAR (1)

MODULI 1. A HYRJE NË EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

KOHA PËR REALIZIM: 1 ORË MËSIMORE - 45 MINUTA

- Aplikimi i metodës së ashtuquajtur "stuhi idesh" - shkëmbimi i njohurive dhe përvojave të mëparshme të pjesëmarrësve të trajnimit në lidhje me ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së si hyrje në orën mësimore.

TEMAT QË DO TË SHITJELLOHEN:

- Parimi i subsidiaritetit si parim themelor i sistemit të konventës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut;
- Obligimi për ekzekutimin e detyrueshëm të aktgjykimeve, që rrjedh nga neni 46 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Dallimi në koncept ndërmjet masave të veçanta (individuale) dhe masave të përgjithshme për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së;
- Natyra deklarative e aktgjykimeve të GJEDNJ-së;
- Indikacionet në aktgjykimet e GJEDNJ-së me të cilat është konstatuar shkelje e KEDNJ-së në lidhje me masat që duhet të ndërmerren me qëllim të ekzekutimit të aktgjykimeve;
- Shkalla e lirisë (liri veprimi) së organeve kompetente shtetërore lidhur me zgjedhjen e masave për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së;
- Roli mbikëqyrës i KM-së në procesin e ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së;
- Procedura për shkeljen e nenit 46 paragrafi 4 të KEDNJ-së.

DOKUMENTET, MATERIALET E PUNËS DHE BURIMET E TJERA MËSIMORE

- Rregullat e Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve dhe të kushteve për ujdinë miqësore [Rules of the Committee of Ministers for the supervision of the execution of judgments and of the terms of friendly settlements, adopted by the Committee of Ministers on 10 May 2006 at the 964th meeting of the Ministers' Deputies and amended on 18 January 2017 at the 1275th meeting of the Ministers' Deputies]⁵.
- Botimi "Ekzekutimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe konteksti institucional kombëtar" i Misionit të OSBE-së në Shkup.

MODULI 1. B SISTEMI PËR EKZEKUTIMIN DHE MBIKËQYRJEN MBI EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

KOHA PËR REALIZIM: 3 (TRE) ORË MËSIMORE NGA 45 MINUTA, NGA TË CILAT:

- 2 (dy) orë kushtuar sistemit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së të Këshillit të Evropës dhe
- 1 (një) orë kushtuar sistemit kombëtar të ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së.

Ora 1 dhe 2 e Modullit 1. B

TEMAT QË DO TË SHTJELLOHEN:

- Reformimi i sistemit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së;
- Sistemi i planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit;
- Sistemi "me dy korsi" - mbikëqyrja standarde dhe e përforcuar;
- Dallimet në lidhje me ekzekutimin e vendimeve për ujdinë miqësore dhe deklaratat e njëanshme dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të tyre;
- Rezolutat dhe vendimet e përkohshme dhe përfundimtare (finale) si akte të KM-së, pjesëmarrja e aplikantëve dhe e subjekteve të tjera të interesuara në mbikëqyrjen e procesit të ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së;

5 Në dispozicion në gjuhën maqedonase në: <https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2020/10/%D0%9F%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B8%D0%BB%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%9A%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%9C%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B8.pdf>

- Kërkimi ligjor përmes bazës së të dhënave HUDOC-EXEC të Këshillit të Evropës (<https://hudoc.exec.coe.int/>).

DOKUMENTET, MATERIALET E PUNËS DHE BURIMET E TJERA MËSIMORE

- Rregullat e Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve dhe të kushteve për ujdinë miqësore [Rules of the Committee of Ministers for the supervision of the execution of judgments and of the terms of friendly settlements, adopted by the Committee of Ministers on 10 May 2006 at the 964th meeting of the Ministers' Deputies and amended on 18 January 2017 at the 1275th meeting of the Ministers' Deputies].⁶
- Udhëzuesi për hartimin e planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit për ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷
- Botimi "Ekzekutimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe konteksti institucional kombëtar" i Misionit të OSBE-së në Shkup

Ora 3 e modullit 1. B

TEMAT QË DO TË SHTJELLOHEN:

- Korniza normative e Këshillit të Evropës për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së;
- Korniza nacionale, ligjore dhe institucionale për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së;
- Përbërja, roli dhe kompetencat e Komisionit ndër dikasterial për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së;
- Funkcionimi praktik i sistemit për koordinimin e procesit të ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së në nivel nacional;
- Përfshirja e Komisionit të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarëve pranë Kuvendit në procesin e ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së në nivel kombëtar.

6 Në dispozicion në gjuhën maqedonase në: <https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2020/10/%D0%9F%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B8%D0%BB%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%9A%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%9C%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B8.pdf>

7 Guide for the drafting of action plans and reports for the execution of judgments of the European Court of Human Rights, i disponueshëm në: <https://rm.coe.int/guide-drafting-action-plans-reports-en/1680592206>

DOKUMENTET, MATERIALET E PUNËS DHE BURIMET E TJERA MËSIMORE

- Rekomandimi CM/Rec(2008)2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi kapacitetet e brendshme efikase për ekzekutimin e shpejtë të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut [Recommendation CM/Rec(2008)2 of the Committee of Ministers to Member States on efficient domestic capacity for rapid execution of judgments of the European Court of Human Rights, adopted by the Committee of Ministers on 6 February 2008 at its 1017th Session]
- Ligji për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2009, 88/2014 dhe 83/2018)
- Ligji për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2009) dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/2014), me të cilin ndryshohet neni 8 paragrafi 1 i Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2009)
- Rregullorja e Punës së Komisionit Ndër Dikasterial për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁸
- Botimi "Ekzekutimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe konteksti institucional kombëtar" i Misionit të OSBE-së në Shkup
- Ueb-faqja e Byrosë për Përfaqësim pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (<https://biroescp.gov.mk/>).

MODULI 1. C

LLOJET E MASAVE PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

KOHA PËR REALIZIM:

2 (DY) ORË MËSIMORE NGA 45 MINUTA, EDHE ATË:

- 1 (një) orë kushtuar masave të veçanta (individuale) dhe të përgjithshme për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së dhe

